



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përvojë Praktike

Ngarkesa: 12 kredite; 240 orë praktike

Viti / Semestri : Viti II , semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane për arsimin e mesëm të lartë”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: aida.gjinali@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

Programi i praktikës ka për qëllim t'u ofrojë studentëve:

Trajnimi profesional praktik dhe jo vetëm teorik i mësuesit të ardhshëm në këtë fushë që i lejon atij të zbatojë dhe konkretizojë njohuritë e tij të marra më parë. Zbatimi praktik i të gjitha njohurive teorike të marra gjatë studimeve. Përgatitja psiko-pedagogjike e studentit si mësues i ardhshëm. Njohja me rregullat e shkollës dhe zbatimi praktik i tyre. Njohja me programet shkollore dhe në veçanti me lëndën në fjalë. Njohja me dokumentet e shkollës dhe menaxhimi i saktë i tyre. Njohja dhe kontakti i ngushtë me mjedisin e shkollës, klasën, lëndën.

Objektivat specifike lëndore:

Qëllimi i kësaj lënde është t'i ofrojë studentit:

1. Njohuritë e nevojshme për të përmbushur sfidat e mësimdhënies në të ardhmen
2. Njohuritë e kërkuara për të arritur me sukses qëllimet
3. Njohja praktike e roleve të protagonistëve në mësimdhënie - mësimnxënie.
4. Njohuri praktike të etikës profesionale të mësuesve.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti do të jetë në gjendje të zbatojë në mënyrë të pavarur njohuritë teorike në kontekste të vërteta mësimore, duke demonstruar kompetencë profesionale në planifikimin dhe zhvillimin e orëve mësimore.
2. Studenti do të njohë dhe respektojë strukturën organizative të shkollës, rregulloret dhe dokumentacionin shkollor, duke bashkëvepruar në mënyrë efikase me aktorët e tjerë të procesit arsimor.
3. Studenti do të zhvillojë qëndrime etike dhe profesionale si mësues i ardhshëm, duke përvetësuar kodin e etikës së profesionit dhe duke ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme me nxënësit dhe kolegët.